

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA-**, i përbërë nga trupi gjykues Vesel Ismaili kryetar, me anëtarët Valbona Musliu-Selimaj dhe Alltënë Murseli gjyqtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nurije Rexhebeqaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit \_\_\_\_\_ për shkak të veprave penale Vrasje e rëndë në tentative nga neni 147 par.1 nën par. 4 dhe 9 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, dhe veprën penale Mbajtje në pronësi kontroll posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armeve nga neni, 328 par.2, të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.150-6/2012, dt.20.03.2017 e pas zhvillimit të shqyrtimeve gjyqësore verbale e publike, në prezencën e prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari, të akuzuarit \_\_\_\_\_ me mbrojtësin e tij av. \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ i angazhuar sipas autorizimit, i dëmtuari –dëshmitari, \_\_\_\_\_, ekspertit mjeko-ligjor dr. \_\_\_\_\_ me datë 12.03.2018 mori dhe publikisht shpalli këtë:

## AKT GJYKIM

## I akuzuari

\_\_\_\_\_, nga i ati \_\_\_\_\_ dhe nënës \_\_\_\_\_, e gjinisë \_\_\_\_\_ i lindur më dt. \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ ku edhe tani jeton Lagja \_\_\_\_\_ rruga \_\_\_\_\_ kati nr \_\_\_\_\_ ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa dënuar, ndaj tij zhvillohet edhe procedurë tjetër penale për veprë penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 të KPRK-së, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet nënë masën e paraburgimit prej dt.15.02.2017 e tutje.

## ËSHTË FAJTOR

Sepse:

1.Me datën 26.12.2011, rreth orës 18:15, në Prishtinë në rrugën" \_\_\_\_\_ " në lokalitetin \_\_\_\_\_, me dashje e me qellim të hakmarrjes dhe duke e ditur se mund të rrezikon jetën e personave të tjerë, me armën e zjarrit ka tentuar që ta privoj nga jeta të dëmtuarin \_\_\_\_\_ në atë mënyre që për shkak të mosmarrëveshjes paraprake që kishte pasur i akuzuari me tani të dëmtuarin \_\_\_\_\_, i cili më parë kishte shtënë me armë zjarri dhe e kishte qëlluar në këmbë, në pjesën e gjurit të akuzuarin \_\_\_\_\_ i njëjti natën kritike me datën dhe kohën e lartcekur, ka shkuar tek lokali \_\_\_\_\_ ku ishte duke punuar i dëmtuari, i cili në atë moment ka qene duke e rruar në fytyrë tani të dëmtuarin \_\_\_\_\_ dhe pranë tyre duke pritur radhën për tu qethur ka qene i ulur edhe i dëmtuari \_\_\_\_\_ dhe me armën e zjarrit të pa identifikuar deri me tani, shtien disa here në drejtim të dëmtuarit \_\_\_\_\_ e qëllon në të dy këmbët, më pas i akuzuari ik nga vendi i ngjarjes dhe qëndron në arrati deri me dt.15.02.2017, kur është zënë dhe arrestuar nga policia, me \_\_\_\_\_ qe rast nga plagët e shkaktuara i dëmtuari pëson dëmtime të rënda trupore.


Republika e Kosovës  Republika Kosovo

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHEM  
DOKUMENTI ËSHTË I PRAVËSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE, OSNOVNI SUD  
PRISHTINË, PRISTINA

Më \_\_\_\_\_  
Data \_\_\_\_\_

20

Prokuror i shtetit  
Ovajstvo i sudstva



- Me këtë ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë në tentative nga neni 147 par.1 nën par. 4 dhe 9 lidhur me nenin 20 të KPK-se.

2. Nga data 26.12.2011, i akuzuari e mban në pronësi, në posedim, në shkelje me ligjin e zbatueshëm për armët e tilla, armën e zjarrit të pa identifikuar deri më tani, me të cilën me datën e lartë cekur ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitivin e parë.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll në posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së.

Prandaj gjykata konform nenit 3,4,41,43,45, dhe neni 147 par.1 nënpar. 4 dhe 9 lidhur me nenin 20 dhe nenit 328 par.2 të KPK-se, si dhe 359, 365, 366, të KPPRK-së, i shqipton

## DËNIM ME BURG

### Të akuzuarit:

Për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) viteve e 6 ( gjashte) muaj**.

Për veprën penale nën pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton dënimi burgu në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**.

Konform nenit 80 par.1 të KPRK-së ndaj të akuzuarit i shqipton dënim unik në kohëzgjatje prej **4 (katër) vite**.

Në dënimin e shqiptuar me burg do ti llogaritet edhe koha e kaluar nënë masën e paraburgimit nga dt. 15.02.2017, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi por jo më gjatë sesa dënimi i shqiptuar.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore ti paguaj shumën aq sa do të bëhen sipas fletëshpenzimorës së kësaj gjykate, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **50 (pesedhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari . . . . . deklaron se nuk do të ushtroi kërkesë pasurore-juridike .

## ARSYETIM

### HISTORIA PROCEDURALE

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP./I.nr.150-6/2012 dt.30.03.2017 ndaj të akuzuarit duke e akuzuar atë për kryerje të veprave penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni

147 par.1 nën par.4 dhe 9 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, dhe veprën penale Mbajtje në pronësi në kontroll ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPRK-së.

Më Aktgjykimin e kësaj gjykate PKR.102/17 dt.28.09.2017 i akuzuari është shpall fajtor dhe është gjykuar me dënim burgimi unik në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muajve.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjorë kanë ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit av. dhe i dëmtuari

Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të ankesave të ushtruara me aktvendimin PAKR.531/2017 dt.04.12.2017 e ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit dhe lënden e ka kthyer në rigjykim, por ndaj të akuzuarit ka rekomanduar që ti vazhdohet masa e paraburgimit

Lidhur me këtë çështje penale Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, me dt. 7.3.2018, në të cilën seancë kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari, i dëmtuari-dëshmitari dhe i akuzuari me mbrojtësin e tij nga i angazhuar sipas autorizimit, eksperti mjeko-ligjorë dr. dhe pas leximit të dispozitivit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i akuzuari ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë, për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet.

Gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdohet me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare në tërësi ka mbetur pranë aktakuzës së ushtruar kundër të akuzuarit sikurse edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësorë të kaluar, ngase me provat e siguruara në procedurë hetimore si dhe provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore në mënyre të plotë është vërtetuar gjendja faktike, në bazë të cilave vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjendja faktike në këtë çështje penale vërtetohet në bazë të dëshmisë së të dëmtuarve dëshmitarëve të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e që i dëmtuari lidhur me rastin se si ka ardhur deri te ky konfliktë se për shkakë të mosmarrëveshjeve të mëparshme në mesë të tani të dëmtuarit dhe të akuzuarit e që tani i dëmtuari e kishte plagosur me armë zjarri tani të akuzuarin, ky i fundit në shenjë hakmarrje natën kritike, ka shkuar tek lokali ku ka qenë duke punuar i dëmtuari, me armë zjarri e kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, andaj i propozoj gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Pavarësisht se sot në këtë seancë të shqyrtimit gjyqësor i akuzuari për ti ikë përgjegjësisë penale e tregoi një fakt të ri të cilin nuk e ka prezantuar deri më tani, gjoja se babai i tij tani i ndjerë e ka kryer veprën penale për të cilën i akuzuari është tani duke

u gjykuar, atëherë i propozoj gjykatës që kësaj rrethane të mos ia fal besimin, ngase i akuzuari përpiket ti ik përgjegjësisë penale.

I dëmtuari- dëshmitari në dëshminë e tij thekson: se mbes në tërësi pranë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin e kaluar gjyqësor, dhe në vazhdim thekson: se pasi jam plagosë zvarrë kam dal deri te dera e lokalit, kokën e kam pasur të kthyer kah rruga, e kam pa cili në dorë e ka pas kallashin, dhe derisa është larguar nga vendi ka zgjatur dikund përafërsisht rreth 40 sekonda.

Para se të filloj me gjuajt me kallash unë e kam parë në pasqyrë i cili ka qenë në pozitë të gjuajtjes me armë, nga se kallashin e kishte pas të drejtuar nga unë.

Kur kam dal te dera e lokalit ka qenë në anën e djathtë të krahut tim , dhe ka qenë duke e ndërruar karikatorin e kallashit. Nuk e di se a e ka ndërruar karikatorin e kallashit apo jo, se veç atëherë ka filluar të më humb vetëdija nga gjakderdhja e madhe që e kam pas . Rasti ka ndodhur rreth orës 18:15 min. dukshmëria ka qenë e mjaftueshëm ngase ka qenë drita e ndezur në lokal dhe jashtë lokalit. Xhamat e lokalit nuk kanë qenë të avulluar se sikur të kishin qenë të avulluar unë s'kisha muajt me pa.

Pasi jam plagosur kam biseduar me një plak në rrugë i cili më tha “o bac jo unë po qaj me kallash” dhe këto fjalë mi ka thënë pasi që unë e kam pa në rrugë. Ka pas edhe kerre natën kritike por nuk e di se ka qenë Mercedes apo qfare, por e di që është ndalur dhe ka mundur të largohet me atë kerr, gjithashtu as ngjyra e kerrit nuk më kujtohet a ka qenë metalike apo qfarë.

Para dy vitesh ka ardhur personi me emër i cili ka thënë se më ka dërguar për pajtim dhe a mundeni me u pajtua , por unë e refuzova i thashë jo dhe më nuk ka qenë askush.

Që nga viti 2015 unë nuk kam pas kontrole mjekësore për këmbë , por gjendjen e këmbës nuk e kam të mirë sidomos kur ndryshon koha ndiej dhimbje dhe pirje, mbes në tërësi pranë dëshmisë së dhënë në seancën e shqyrtimit të kaluar, anëtarët e familjes së i kam njohur, gjithashtu të ndjerin (babain e të akuzuarit) e kam qethur, dhe ai natën kritike kur jam plagosur fare nuk ka qenë aty

Gjate fazës se rigjykimit kryesor është dëgjuar eksperti mjeko-ligjor Dr. , i cili në pika të shkurta elaboroi ekspertizën mjeko-ligjore ndaj të dëmtuarit dhe ka bërë ekzaminimin fizik të dëmtuarit si procedurë kon firmuese e gjendjes aktuale shëndetësore të të dëmtuarit e i njëjti shtoj se: ka pasur dëmtime të rënda trupore me pasoja të përhershme në shëndet kur edhe e kemi bërë ekzaminimin e detajuar klinik dhe ekzaminimin e rëntgëneve të pranishëm në dokumentacionin mjekësor. Plagët ku i ka marrë i dëmtuari janë regjioni i atakuar si pasojë e plagës tej shkuese nga arma e zjarrit konsiderohet si regjion vital i organizimit të njeriut ku kryen funksione të rëndësishme jetësore e mbi bazën e të cilave është dhënë edhe mendimi.

Me lejen e trupit gjykues eksperti i mjekësisë ligjore Dr. ndaj të dëmtuarit edhe në sallë të gjykimit bënë shikimin e gjendjes faktike –ekzaminimin vizuel të këmbës së majtë në pjesën e nën gjurit në pjesën ku është shkaktuar lëndimi me armë zjarri, lidhur me gjendjen aktuale të plagës e që:

Dëmtimet i përshkruan njësoj si në ekzaminimin fizik mjeko-ligjor .

- Plagë tejshkuese nga arma e zjarrit
- Thyerje e shumëfishtë e kockave të nën gjurit të majtë
- Dëmtim i muskulit soleus, muskujve fleksor të gishtërinjve, muskulit të mëparshëm tibial të v.muskulit fibular të majtë dhe nervit peroneus të majtë.
- Dëmtimet janë shkaktuar si rezultat i veprimit dinamik të predhës së hedhur nga armë zjarrit.
- Dëmtimet e tilla bëjnë pjesë në **“DËMTIME TË RËNDA TRUPORE.”**
- Pasojat në shëndet kualifikohen bazuar në raportet mjekësore nga vizitat kontrolluese mjekësore.

Të lartcekurat janë në bazë të mendimit të ekspertit mjekësor dhe mbi raportin mjekësor të përpiluar në lëndë, të gjitha të konsideruara shumë të besueshme dhe të sigurta.

Dokumentacioni mjekësor përmban të gjitha rezultatet e ekzaminimit mjekësor , puna e ekspertit ka qenë objektive dhe e paanshme, materiali për kahe kualiteti dhe kuantiteti, ka qenë i mjaftueshëm.

Trupi Gjykues me pëlqimin e të gjitha palëve në procedurë ka konsideruar si te lexuara ne procesverbal, si ne vijim: - Dëshminë e dëshmitarëve dhe të dhëne në shqyrtimin gjyqësorë më datë 15.06.2017.

Dëshminë e dëshmitarit dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.11.05.2017

Përmbledhje e Provave, dëshmitë e administruara në këtë rigjykim kanë te bëjnë vetëm me akuzën e veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par.1 nën par 4 dhe 9 lidhur me nenin 20 të KPK-së, dhe veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPRK-së. Lista e plotë e dëshmimeve te prezantuara dhe të shpallura të pranueshme në Procesverbalet të seancës se shqyrtimit kryesor .

Konform nenit 386 par.2 të KPPRK-së, këto prova formojnë bazat për vendimin e Trupit Gjykues në këtë lëndë pasi që është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dëshmitë e tyre mund te ndahen ne këto tri kategori: -Personat e pranishëm afër, apo në vendin e ngjarjes , para gjatë apo pas veprës penale.

Oficerët e Policisë, pjesëmarrës në hetime dhe të pranishëm në vendin e ngjarjes, Dëshmitaret Ekspert (ekspertet mjekësor dhe te mjekësisë ligjore).

Oficerët e Policisë kanë dhënë dëshmi për vazhdimet dhe veprimet e tyre kur kanë arritur në vendin e ngjarjes me 26.12.2011, dhe mbledhjen dhe mbajtjen e mëtutjeshme të dëshmive në këtë lëndë.

Dëshmia e dëshmitarit \_\_\_\_\_ e dhënë në fazat e mëhershme të kësaj procedure penale me leximin e së cilës palët në procedurë janë pajtuar: bënë përshkrimin e gjendjes faktike të dt.26.12.2011, ku ka theksuar se rreth orës 18:15, i njëjti deri sa ishte duke u qethur dhe rruar në fytyrë në lokalit të dëmtuarit \_\_\_\_\_ ka dëgjuar disa krisma që për momentin ka menduar se janë petardë pasi që ishte koha para Vitit të Ri, me sa i kujtohet kanë qenë diku tri krisma, por mund të ndodh që ka pas edhe më shumë krisma, pasi me që rast ka qene shumë afër të dëmtuarit \_\_\_\_\_ dhe se pastaj ka vërejtur të dëmtuarin të shtrirë në dysheme me trup dhe kokë nga dera. Pasi është rrëzuar berberi unë jam ngritur në këmbë nga karrika ku isha ulur nuk kam vërejtur diçka tek unë, andaj kam dalur jashtë derës së lokalit e kam vërejtur më duket një veturë Golf II, por nuk jam i sigurtë por një kalimtar i rastit më tha se qaj kerri gjuajti. Kur kam bisedu me atë personin e moshuar ai më tha se kerri që ishte duke kaluar te pompa e benzinës tha se prej atij kerri kanë gjuajti.

Gjetjet e gjykatës janë se kjo dëshmi është në përputhshmëri të plotë me dëshminë edhe të dëmtuarit, për rezultatin e përlshjes si dhe çfarë kanë parë kur kanë filluar krismat nga armët e zjarrit ose kur kanë përfunduar.

Po ashtu me pajtimin e palëve në procedurë është lexuar dëshmia e dëshmitarit \_\_\_\_\_ lidhur me këtë çështje juridiko penale i cili dëshmon: më kujtohet se diku një javë para vitit të ri përafërsisht rreth dt.26.12.2011 ka ndodhur rasti, në atë kohë kam qenë duke punuar në një depo në \_\_\_\_\_, pas përfundimit të orarit të punës kam shkuar për ti qethur flokët tek \_\_\_\_\_ të cilin e kam dajë. Koha kur kam arritur tek \_\_\_\_\_ ka qenë diku rreth orës 18:00, jam ulë për me prit në radhë, ndërsa më kujtohet ka qenë duke u qethur një klient, aty ka qenë edhe stufa e ndezur, unë kam qenë i ulur në karrigen anash nga \_\_\_\_\_ ku ka qenë duke e qethur një person, maksimumi ka qenë diku 2-3 m, unë murin e kam pas mbrapa dhe derën e kam pas përballë, kuptohet dera ka qenë me xhama dhe kam parë gjithçka, \_\_\_\_\_ ka qenë duke punua, pas përafërsisht 15 min. Kur kam hy në lokal te \_\_\_\_\_ ka ardhur i akuzuari \_\_\_\_\_ dhe i është afruar derës së lokalit, në një afërsi prej një hapi, nuk e ka hapur fare derën e lokalit dhe me kallash ka fillua me gjuajt saktësisht nuk e di çfarë arme por mu ka duk si kallash sepse ishte armë e gjatë, saktësisht nuk e di se sa ka gjuajt por e di se shumë herë, e gjithë krisma nga ana e \_\_\_\_\_ ka zgjatur diku me sekonda, krismat kanë qenë të shpejta njëra pas tjetrës – rafall, \_\_\_\_\_ u rrëzua në tokë i cili tha thirri policinë, meqenëse isha i ri moshë 18 vjeçare jam frikua, e kam thirr 112 policinë, \_\_\_\_\_ ka qenë i shtrirë në pozitë gjysmë në krah gjysmë në shpinë, bashkërisht me personin i cili ka qenë brenda në lokal, e kemi kapur \_\_\_\_\_ e kemi fut në veturën time dhe e kemi dërguar në spital.

Jam i sigurt se ka qenë \_\_\_\_\_ vetëm se në atë kohë ka qenë më i dobët, pasi që edhe para këtij rasti e kam njohur. Në kokë \_\_\_\_\_ nuk ka pas asgjë, kurse se çka ka pasur

veshur tani nuk më kujtohet, personi që ka qenë duke u qethur siç theksova më lartë ka qenë i ulur në karrige kurse ka qenë duke e qethur, por me rastin e krismave të armës fillimisht ka qenë i shtanguam ulur, por më pastaj është ngritur në këmbë, dukshmëria ka qenë e mirë pasi që lokali ka qenë i ndriçuar si brenda ashtu edhe jashtë por kanë qenë edhe dritat e rrugës të aktivizuar kështu që në atë afërsi dukshmëria ka qenë e mirë.

pasi që kanë pushuar krismat e kam vërejtur se është larguar në drejtim të Medreses, unë e kam vërejtur vetëm kur është larguar pak, por më tepër nuk e kam vërejtur se jam marrë me

Unë e kam vërejtur 99.9 % që është ai pasi që kanë pushuar gjuajtjet dhe kur ka filluar me u larguar nga vendi i ngjarjes. Xhamat e vitrinës së lokalit dhe të derës kanë qenë të thjeshtë të tejdukshëm. Unë para rastit kritik e kam njohur si figurë nga se kam takuar në lagjen e tek “ ” por me të nuk kam biseduar asnjëherë. Unë e kam pa shpesh herë edhe në bastore në lagjen e “ ”, por a ka punuar aty apo jo nuk e di. ka lëvizur nga vendi ku ka qenë i shtrim zhag në drejtim të derës së lokalit diku rreth përafërsisht gjysmë metër.

Gjykata vlerësoi dëshminë edhe të këtij dëshmitari si dëshmi reale objektive: pasi që ka qenë pjesë e zhvillimit të kësaj ngjarje, dëshmia e të njëjtit është vërtetë se ai e ka parë natën kritike të akuzuarin i njëjti ka qenë me armë para lokalit dhe drejtuar tani të dëmtuarit dhe dukshmëria sipas këtij dëshmitari ka qenë e mirë, po ashtu edhe në deklaratat e mëhershme arsye pse ka ndodhur ky rast nuk e di, por e dinë që i dëmtuari dhe i akuzuari ka qenë në hasmëri në mes vete. Ky ishte një dëshmitar direkt, dëshmitar i veprës, i cili e ka vërejtur me shqisa të veta rrjedhën e veprës për të cilën deklaroi, në të vërtetë dëshmitarët i krijon vetë rasti, faktin se në momentin dhe në vendin ku është kryer vepra penale janë ndodhur aty me shqisat e tyre me shikim e ka vërejtur atë që ka ngjarë dhe për këtë është shumë i sigurt se kryes i kësaj vepër penale është tani i akuzuari ngase natën kritike në vendin e ngjarjes e ka pa jashtëzakonisht mirë, e ka identifikuar sepse edhe më parë e ka njohur, po në këtë raste edhe vetë ka qenë i rrezikuar për jetë se gjatë gjithë kohës sa kanë zgjatur krismat e armës së zjarrit ka qenë brenda lokalit në afërsi prej 1.5 deri 2.00 metra me tani të dëmtuarin, e gjithashtu edhe më i rrezikuar ka qenë edhe dëshmitari tjetër Flamur Shehu i cili në momentin e shkrepjes së plumbave nga arma e zjarrit nga ana e të akuzuarit ka qenë i ulur në karrigen, e që i dëmtuari ka qenë mbi kokën e tij duke e qethur.

Me pajtimin e palëve është lexuar dëshmia e dëshmitarit i cili thekson: para këtij rasti nuk e kam njohur fare, por atë e njoh nga rasti kur është plagosur në këmbë nga

Ka 30 vite që unë shoqërohem me, dhe e di që ka lidhje familjare me unë para i kam dërguar edhe shumë njerëz te tjerë për tu pajtuar, por i njëjti nuk ka pranuar dhe vazhdimisht ka thënë se do të hakmerret,

unë e kam dërguar tek familja e për pajtim i njëjti është kthyer në shtëpinë time, dhe më ka treguar se nuk donë të pajtohet vet

Nuk e di se çka e ka shtyrë me që të vijnë deri tek këto probleme në mes tyre gjegjësisht te plagosja e nga ana e në atë kohë, vajza ime ka pas sallon frizere, unë e kam ditur që në sallonin e vajzës time është duke punuar edhe një vajzë tjetër për të marrë zanatin, por nuk e kam ditur e cilës familje është, por tash e kam kuptuar se ajo vajzë ka qenë e familjes dhe pas këtij rasti e kam kuptuar se ka qenë vajza e , kurrë nuk kam qenë në dijeni që ajo vajzë e familjes ka pas punë apo ndonjë lidhje me djalin tim e kam njohur vetëm pas rastit kur është plagosur nga djali im.

Djali im ka qenë berber edhe tani është, para ndodhjes së rastit më kanë thënë se edhe anëtarët e familjes kanë shkuar dhe janë qethur aty, kurse për nuk më kujtohet se ka thanë se edhe ky ka shkuar me u qeth aty a jo.

Gjykata e vlerësoi dëshminë e këtij dëshmitari si pjesërisht reale , pasi që i njëjti nuk ka qenë drejtpërdrejt pjesë e zhvillimit të kësaj ngjarje , i njëjti nuk e di se pse ka ardhur deri te përleshja dhe nuk e di çfarë e ka shtyrë ta plagos tregon se vajza e tij ka pasur një sallon frizere dhe motra e ishte në praktikë aty, nuk e di a ka pas ajo vajzë ndonjë lidhje me djalin e tij , Ky ishte një dëshmitar sipas dëgjimit (Dëshmitarë ex audity) nuk e ka perceptuar vetë rrjedhën e veprës, por flet për tregimin e personave të tretë të cilët i kanë treguar për zhvillimin e ngjarjes.

Gjate fazës se rigjykimit kryesor janë prezantuar dhe lexuar provat ne vijim:

Lexohet raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt.26.12.2011.

Lexohet lista e dëshmive e dt.26.12.2011.

Lexohet raporti i ekspertizës nga Njësia për ekspertim të armëve të zjarrit të dt.07.03.2012.

Lexohet mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. : dt.07.03.2017 për të dëmtuarin

Dosja e shkresave të lëndës hetime dhe prova ,Raporti nga njësia e Hetimeve Rajonale me nr.rastit 2011-AC-2173.

Nga raporti i këqyrjes i vendit të ngjarjes i dt.26.12.2011 vërtetohet fakti se në rrugën janë gjetur gëzhoja fisheku, kurse para lokalit ishin dy gëzhoja dhe njolla gjaku, xhami i derës së lokalit ishte i thyer.Në brendi të lokalit kishte njolla të mundshme gjaku.

Nga lista e dëshmive e dt.26.12.2011, vërtetohet fakti se janë gjetur një gëzhojë me mbishkrimin bazik 61 69, një gëzhoje me mbishkrimin bazik 3 83 , një gëzhoje me mbishkrimin bazik 61 69 ,dy predha të dëmtuara.



Nga dosja e shkresave të lëndës që janë përmbledhur hetime dhe prova nga raporti i dt.26.12.2011, sipas raportit të shpejtë është raportuar për një plagosje me armë zjarri, i cili ka ndodhur në rr.

Nga Raporti i njësisë së Hetimeve Rajonale me nr.rastit 2011-AC-2173 ,vërtetohet fakti se njësiti kanë dalë në vendin e ngjarjes, dhe në intervestimin e dëshmitarit deklaroi se i dyshimti është

Nga foto albumi i cili gjendet në shkresat e lëndës me nr.dosjes 2011-AC-2173 i dt.26.12.2011 , vërtetohet fakti se në rr. ku në anën jugore të rrugës ishte lokali në të cilin kishte ndodhur vrasja në tentativë.

Po ashtu vërtetohet fakti se në foton nr.3 është gjetur gëzhoja e armës e cila ishte në rrugën , pamjet e gjendjes faktike pranë derës së lokalit ku shihen njolla të mundshme të gjakut, njollat e gjakut në dyshtemenë e Lokalit

Nga raporti i ekspertizës nga Njësia për ekspertim të armëve të zjarrit të dt.07.03.2012 sipas dëshmisë së dorëzuar VN#2, VN#4 dhe VN#5 janë tri gëzhoja pjesë të fishekëve të kalibrit 7.62x39 mm të cilat janë gjuajtur shkrepur nga një armë e zjarrit e po të njëjtit kalibër 7.62x39 mm si psh"AK-47", "TYPE-56", "TYPE-68", "SKS".

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar veq e veq në pajtim me dispozitën e nenit 387 të KPRK-së, kurse lidhur me provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 396 par.7 të KPPRK-së, duke cekur në mënyrë të plotë se për çfarë faktesh dhe arsyes i konsideron të provuara duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore me të cilat ka nxjerrë një përfundim të qartë dhe konkret .

Mbrojtësi i të akuzuarit av. thekson: i gjithë rasti është ndërtuar nga ana e Prokurorisë, duke u mbështetur vetëm në deklaratat e dëshmitarëve, deklarata të cilat fakt që tregojnë ndodhjen e një ngjarje , këtë rast plagosjen e

Nga të gjithë dëshmitarët e dëgjuar dëshmitë e tyre janë dëshmi subjektive, duke pas për bazë lidhjet familjare mes tre dëshmitarëve me të dëmtuarin, e që ishin: babë bir dhe djalë i motrës të cilët me çdo kusht mundohen që përgjegjësinë për kryerjen e veprës penale t ia vënë të mbrojturit tim, i vetmi dëshmitar i cili mundohet ta shpjegojë rastin konsiderohet si dëshmitar objektiv nuk ka ndonjë lidhje familjare me të dëmtuarin dhe të akuzuarin, mundohet ta shpjegojë rastin ashtu siç ka ndodhur pa përmendur emra, pa theksuar se a kishte parë ndonjë person me kallash në dorë jashtë, vetëm se i njëjti thotë që kemi dal jashtë, një person i moshës madhore na ka thënë që qajo vetura që shkoj ka gjuajte, pa përmendur se kush ishte apo nëse ka mund ta vërej ndonjë person tjetër, konsideroi se këto deklarata janë me shumë supozime po ashtu edhe në to ka ndryshime thelbësore të dhëna në polici në prokurori.

**I akuzuari** në mbrojtjen e tij thekson: unë sa kam qëndruar jashtë Kosovës, kam pasur kontakte me familjarët e mi përmes telefonit, babai im më ka treguar se e ka plagosur , i cili nuk ka dashur me u pajtua me dhe

familjarët e tij , edhe për kundër faktit se unë nuk kam qenë i interesuar të hakmerrem ndaj , këtë punë ja kam lënë drejtësisë , mua më ka thënë ti dil jashtë shtetit se unë e kryej këtë punë.

Në Kosovë unë jam kthyer në Janar-Shkurt të vitit 2015, për arsye se babait tim ju përkeqësua gjendja shëndetësore edhe për kundër se babai im nuk ka qenë i pajtimit që unë të kthehem , ai ishte kundër sepse më thoshte se mund të hakmerren familja e , nuk e di se kush tjetër në familjen time e ka ditur që e ka plagosur babai im.

Dua të shtoj se edhe në Prokurori por edhe në Gjykatë kam deklaruar se kur kam kuptuar për plagosjen e kam qenë në një SONY PLAYSTATION, ngase nuk kam dashur që të tregoj se e ka plagosur babai im tani i ndjeri.

Por sot që po e them këtë është më se e vërtete se në kohën kur është plagosur kam qenë në ajo çka më shtyri që ta ndërroj deklaratën sot nga seancat e kaluara ishte se nuk e kam ndier veten fare fajtorë për këtë vepër penale për të cilën po akuzohem , por pasi që po e shoh që drejtësi nuk ka përkundër dhe po dënohem mbi bazën e një deklarate, po e shoh të arsyeshme ta them të vërteten.

Gjykata pas shqyrtimit, vlerësimit dhe krahasimit të mbrojtjes së të akuzuarit në këtë seancë të shqyrtimit gjyqësorë vërtetoi se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilat akuzohet, por i njëjti me këtë mbrojtje dhe këtë skenë të inskenuar është në kundërshtim me logjikën dhe pohimin e vet të akuzuarit , sepse këta edhe më herët nuk kishin raporte të mira me familjen i dëmtuari kishte plagosur më parë të akuzuarin Hamdi, dhe kishte vuaj dënimin për këtë vepër.

Andaj me të drejtë konsiderojmë se skena e inskenuar nga i akuzuari se kinëse babai i tij i ndjerë e ka plagosur tani të dëmtuarin , është spekulim i cili duhet të përjashtohet sepse i akuzuari me këtë spekulim veç sa tenton që ti shmangët përgjegjësisë penale për veprën e kryer penale.

Përkitazi me këtë mbrojtje i akuzuari gjatë shqyrtimit të kaluar gjyqësorë deklaroj krejt diçka tjetër, tani deklaron krejt diçka tjetër, ku edhe vet gjendet në një pozitë kundërthënëse dhe për qëndrimin e tij në nuk ishte në gjendje të ofroj ndonjë dokument apo provë që ta bindë trupin gjykues qëndrimin e tij në në kohën e kryerjes së veprës penale.

Të gjitha provat indirekte kundër të akuzuarit të vlerësuar në mënyrë individuale dhe në lidhje me njëra tjetrën qojnë në përfundim se i akuzuari e ka plagosur të dëmtuarin në shenjë hakmarrje për plagosjen e më hershme nga tani i dëmtuari

Aktgjykimi dënues bazohet në prova indirekte , vetëm atëherë kur me të konstatohen një sërë faktesh të cilat vërtetohen përtej dyshimit të arsyeshëm dhe se janë të lidhura ngushtë në mënyrë logjike ,kështu që ato e përfaqësojnë qarkun e mbyllur dhe pikën e

pa përkulur nga e cila nxirret vetëm një përfundim i mundshëm , se i akuzuari është kryerës i veprës penale , e cila është objekt i akuzës dhe se deklaratimet dhe provat e paraqitura tani nga i akuzuari përjashtojnë ndonjë mundësi tjetër.

Një fakt tjetër i pa kontestueshëm është se gjykata konsideron se sulmi ka ndodhur në brendi të lokalitit i vetmi konkluzion mund të nxirret nga ky fakt, se sulmi ka zgjatur dhe se i dëmtuari ka qenë i vetëdijshëm, e ka parë ,dhe pa dyshim i tmerruar nga pësimi i sulmit lëndimeve njeri pas tjetrit.

I akuzuari nuk mund të jepte shpjegim të besueshëm se pse ai e ka ndryshuar tregimin e tij të mëparshëm , Megjithatë, në mungesë të ndonjë prove tjetër për të mbështetur alibinë e tij se gjendej jashtë vendit konkretisht në \_\_\_\_\_ , në kohën kur është kryer vepra penale është vetëm spekulim.

I akuzuari \_\_\_\_\_ ka vepruar me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij.

Trupi gjykues arriti në përfundim se i akuzuari ka vepruar me animus necandi. Qëllimi për ta sulmuar të dëmtuarin, që është element i vullnetshëm i futur në ndërgjegjen e personit, mund të nxjerrët vetëm nga provat rreth sjelljes së vrotuar të akuzuarit.

Elementet provuese të prekshme për zbulimin e qëllimit të personit janë, në mes tjerash: sjellja e tij përpara, gjatë dhe pas sulmit, që përbëjnë siç u tha, shprehjet kërcënuese, arma apo instrumenti i përdorur gjatë sulmit, rajoni i trupit i shënuar gjatë sulmit, numri i goditjeve; dhe në përgjithësi ndonjë informatë tjetër që mund të rezultojë nga e veçanta e rastit.

Prandaj është e pakontestueshme që natën kritike i akuzuari i ka shkakuar plagë të rënda të dëmtuarit në këmbë, nuk ka qenë e involvuar asnjë palë e tretë që do të shkaktonte lëndimin e të dëmtuarit.

Palët kanë qenë fqinjë dhe në ato rrethana nuk është e pazakonshme që ata të jenë në dijeni për shprehjet e njëri tjetrit dhe rutina e ditëpërditshme. Për më tepër, pasi që shtëpitë e palëve gjenden shumë afër njëra tjetrës, do të ishte shumë më lehtë për të akuzuarin që ta ballafaqojë palën e dëmtuar saktësisht pranë lokalitit të tij, në një zonë të cilën e njihnte më mirë. Ai ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për potencialin e pasojës së veprimit të tij. Kjo vërteton besimin e trupit gjykues se deklarimi i të akuzuarit \_\_\_\_\_ për babin e tij tani të ndjerë është i trilluar.

Për të përfunduar, në bazë të provave materiale, përfshirë provave të forenzikës dhe duke pasur parasysh kundërthëniet e përmendura dhe pasaktësitë në deklaratat e të akuzuarit, trupi gjykues është i bindur se i akuzuari është në fakt personi i cili filloi sulmin. Duke marrë parasysh këtë, mbrojtja të re konsiderojmë se është e përjashtuar. Trupi gjykues tani kthehet të vlerësojë nëse elementet subjektive (e ashtuquajtura mens rea) të të akuzuarit, janë vërtetuar. Sipas nenit 11 paragrafi 91 të KPK, personi është përgjegjës penalisht nëse ai ose ajo është mendërisht i/e aftë dhe është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale. Në pajtim me dispozitën e njëjtë, një person është fajtor

për kryerjen e një veprë penale kur ai ose ajo kryejnë një vepër penale me dashje apo nga pakujdesia. E para, nuk ka dyshim për sa i përket faktit se i akuzuari ka qenë plotësisht i aftë mendërisht kur ka kryer veprën. Asgjë në dosje të lëndës nuk sugjeron ndryshe dhe nuk është ngritur asnjë kundërshtim i tillë nga mbrojtja. E dyta, i akuzuari, kur ka kryer krimin, ka vepruar me dashje. Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale. Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron .

Jo vetëm që i akuzuari nuk ka zgjedhur që të shmangë ballafaqimin, por ai bile ka marrë një qëndrim aktiv ndaj të dëmtuarit.

Në një situatë konflikti, sjelljet shoqërore do të ishin brenga e fundit për çdo person të arsyeshëm. Në realitet, kjo vërteton që i akuzuari ka marr rol aktiv në konflikt dhe që ai në fakt i është afruar palës së dëmtuar. Në mbështetje të këtij përfundimi është edhe fakti që incidenti ka ndodhur në lokalitetin e tani të dëmtuarit.

Këtij shpjegimi konsiderohet se i mungon logjika. Pse do të zgjedhte dikush që të humbas momentin dhe elementin e befasisë së një sulmi duke e sjell objektivin nga njëra anë në anën tjetër të rrugës.

Trupi gjykues është i mendimit që lokacioni i konfliktit (ana e majtë e rrugës) tregon për faktin që në të vërtetë i akuzuari e ka ndjekur palën e dëmtuar.

Si rrjedhojë, arma me të vërtetë nuk u gjet asnjëherë nga policia. Kjo dëshmon faktin se i akuzuari kishte për qëllim të heq duarsh armën dhe prandaj ishte i vetëdijshëm se kishte bërë diçka të paligjshme dhe përpiquej të mbulonte atë që kishte bërë dhe iku menjëherë nga vendi i ngjarjes.

Për dallim, menjëherë pas incidentit pala e dëmtuar ishte i hutuar dhe kur transportohej në spital ai vazhdonte të pyeste se çka ka ndodhur

Vetëm gjatë procedurës gjyqësore i akuzuari filloi të përdorë këtë linjë të re të mbrojtjes.

Kjo vërteton besimin e trupit gjykues se deklarimi për babai e tij është i trilluar.

I akuzuari e ndryshoi deklaratën e tij rrënjësisht para trupit gjykues, ku vazhdimisht deklaronte se çdo çështje e kaluar në mes tij dhe palës së dëmtuar ishte zgjidhur shumë kohë më parë. Megjithatë, në bazë të provave të cilat u përmenden më herët, trupi gjykues gjen deklaratën e të pandehurit kontradiktore dhe të pasinqertë. Për më shumë, i dëmtuari kishte shumë frikë nga i akuzuari dhe përpara incidentit ai vazhdimisht i shmangej atij.

Sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, trupi gjykues duhet të vërteton në rigjykim "specifikisht nëse ekziston qëllimi i të akuzuarit për të kryer veprën penale si në aktakuzë apo a jemi në fakt duke u marrë me një vepër penale ndryshe, përkatësisht a është vënë jeta në rrezik edhe e personave të tjerë të cilët kanë qenë prezent siç janë dhe

Gjykata ka vërtetuar faktin se kanë qenë të rrezikuar për jetë se gjatë gjithë kohës sa kanë zgjatur gjuajtjet e plumbave nga arma e zjarrit nga ana e të akuzuarit, që të dytë kanë qenë brenda lokalit në afërsi prej 1.5 deri 2.00 metra me tani të dëmtuarin

, e gjithashtu edhe më i rrezikuar ka qenë dëshmitari tjetër i cili në momentin e shkrepjes së plumbave nga arma e zjarrit nga ana e të akuzuarit ka qenë i ulur në karrigen, e që i dëmtuari ka qenë mbi kokën e tij duke e qethur.

Dëshmitë e dëshmitarëve dhe janë dëshmitë e vetme që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me dinamikën e përleshjes.

Ato janë relevante për vërtetimin e aspekteve në lidhje me veprat penale për të cilat është i ngarkuar i akuzuari.

Këto dëshmi përbëhen prej deklaratave të dëshmitarëve dhe raporteve mjekësore të palës së dëmtuar.

Prandaj, ne i kemi vërtetuar dy mundësi: I akuzuari e ka zënë në flagrancë të dëmtuarin i akuzuari i është afruar palës së dëmtuar me qëllime agresive.

Karshi logjikës së avokatit mbrojtës sipas të cilit shfajësohet i akuzuari nga akuza, sipas mbrojtjes provat e paraqitura në shqyrtimin kryesor janë plotësisht konsistente mbi skenën sipas të cilit ndokush tjetër ka tentuar ta kryejë këtë veprë penale gjatë kohës kur i mbrojturi i tij kinse ishte jashtë vendit.

Avokati mbrojtës argumenton se rezulton një rrethanë tjetër shfajësuese, po ashtu potencon mungesën e shkakut ose motivit në anën e të akuzuarit.

Gjatë shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit të shpallur fajtor për një krim të caktuar, trupi gjykues duhet të ketë ndërmend edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit – do të thotë të ndalojë aktivitete të rrezikshme shoqërore duke përmbytur të tjerët nga kryerja e veprave të njëjta penale, edhe qëllimin specifik – do të thotë parandalimi i kryerësit nga përsëritja e veprës penale. Sipas nenit 41 të KPRK-së “Qëllimet e dënimit janë: 1) Të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij dhe 2) të përmbyjë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale”. Dy qëllime tjera të dënimit që referohen zakonisht nga ekspertët e kriminologjisë dhe penologjisë janë ndëshkimi dhe rehabilitimi. Prandaj, trupi gjykues duhet të merr parasysh të gjitha këto qëllime kur e përcakton dënimin.

Prandaj, trupi gjykues duhet të konsiderojë parimin e pakundërshtueshëm të lex mitior. Trupi gjykues duhet që in concreto të ketë parasysh cili ligj do të jetë më i favorshëm për të akuzuarin gjatë llogaritjes së dënimit. Siç u cekë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), lex mitior është ai i cili është më i favorshëm për të akuzuarin duke marrë parasysh karakteristikat e tij ose të saj, natyrën e veprës dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra prandaj lex mitior duhet të konstatohet in concreto.

Gjykata e cakton dënimin për veprë penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë veprë penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese) si rrethanë lehtësuese gjykata morri parasysh se i akuzuari pati qëndrimin korrekt në gjykatore, se është i moshës së re, se më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, e si rrethanë rënduese gjeti shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit. Trupi gjykues e konsideron sulmin e të akuzuarit ndaj fqinjit të tij-të dëmtuarit një akt kriminal posaçërisht të rëndë. Mënyra të tilla të zgjidhjes së konflikteve në mes njerëzve nuk mund të tolerohen dhe dënimi i shqiptuar duhet të reflektojë këtë.

Duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura më lartë, trupi gjykues e dënoi të akuzuarin për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve e 6 ( gjashte) muaj, për veprën penale nën pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi e dënoi me dënimi burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti .

Në pajtim me nenin 80 paragrafi 1 të KPRK-së ,që rregullon shqiptimin e dënimeve për bashkimin e veprave penale, trupi gjykues i shqiptoi të akuzuarit dënimin unik prej 4 vite burgim.

Gjykata është e bindur se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së, ashtu që do të ndikojë në mënyre preventive ndaj të akuzuarit që mos të kryej vepra penale si dhe ndaj personave tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprës penale të natyrës së tillë

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 6 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij atgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr 373/17 dt.12.03.2018**

**Procesmbajtësja**  
Nuriye Rexhëbeqaj

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari**  
Vesel Ismaili

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditsh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Exp  
P  
Ankues  
mbledhje